

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI KUSHTETUES ADMINISTRATIV



PUNIMDIPLOME

MASTER

**TEMA: “MBROJTA DHE GARANTIMI I LIRISË SË BESIMIT FETAR NË REPUBLIKËN
E KOSOVËS”**

Kandidatja:

Bsc. Ajshe Lushtaku

Mentori:

Prof.Asoc.Dr.Murat Jashari

PRISHTINË, 2023

Abstrakt

Liria e besimit fetar është një ndër liritë themelore të njeriut të garantuara dhe mbrojtura me instrumente juridike ndërkombëtare e kombëtare dhe hyn në kuadrin e lirive të njeriut që përbëjnë një rëndësi kyçe në jetën shoqërore të secilit individ. Liria e fesë është një parim që mbështet lirinë e një individi ose të një komuniteti, në publik ose në mënyre private, për të manifestuar fenë ose besimin dhe atë në mësim, praktikë, adhurim dhe respektim. Gjithashtu përfshinë lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe për ta deklaruar haptazi pa pasur frikën e diskriminimit bazuar në këtë aspekt.

Është një nga liritë themelore të njeriut e cila i takon çdo individ kudo në botë, por jo gjithmonë garantohet në mënyrë të njëjtë në te gjitha shtetet. Ka vende ku kjo e drejtë përmes mjeteve të caktuara shtetërore cenohet, shkelet apo shtypet. Në disa vende të botës shpesh liria e besimit shpërfillet dhe cenohet duke detyruar besimtarët e feve të caktuara të luten fshehurazi ose të kenë frikë të besojnë atë që duan të besojnë. Marrë parasysh shumë prej ngjarjeve të viteve të fundit dhe jo vetëm, shumë prej njerëzve që duan të shprehin haptazi mendimin e tyre lidhur me besimin fetar, jo vetëm se diskriminohen por kalojnë edhe neper tortura të ndryshme, rrihen, burgosen, ndalohen, madje bota njih raste kur dënohen me vdekje.

Pikërisht për këto arsye shumë kohë më parë, ka lindë nevoja që e drejta e shprehjes së lirë të mendimit dhe liria e besimit fetar të mbrohet dhe garantohet me mekanizma shtetëror dhe ndërkombëtar, si çështje e një rëndësie esenciale për mirëqenien e përgjithshme. Prandaj në vitin 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, është miratuar Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, që në vete përfshinte përpjekjen e parë botërore për rregullimin dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut. Po ashtu si vazhde e përpjekjeve për rregullimin dhe mbrojtjen ligjore të të drejtave të njeriut me 1950 Këshilli i Evropës e miratoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila hyri në fuqi në vitin 1953 dhe u miratua e u ratifikua në shumë shtete. Kjo konventë në vete rregullon shumë qartë dhe specifikisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ndër to përfshihet edhe liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Për zbatimin e mirëfilltë të kësaj konvente nga vendet që e kanë ratifikuar dhe inkorporuar në sistemin e brendshëm ligjor, është themeluar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që është mekanizëm gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave që rregullohen me konventë dhe përbën mekanizëm për kontrollin e zbatimit të konventës po ashtu, ku qytetarët nga shtet anëtare të konventës mund të kërkojnë mbrojtje gjyqësore pranë kësaj gjykate për çdo shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që burojnë nga kjo konventë. Duke pasë parasysh se mbrojta dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një hap para drejt demokracisë dhe një shteti të mirëfilltë edhe Republika e Kosovës me shpalljen e pavarësisë dhe miratimin e Kushtetutës së vendit, në vete ka inkorporuar mjaft instrumente ndërkombëtare që janë bazë e rregullimit, mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut. Në kuadër të kapitullit II të Kushtetutës së Kosovës, është rregulluar më detajisht fusha e të drejtave dhe lirive të njeriut. Madje me qëllim të rregullimit të mirëfilltë ligjor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Kosova ka miratuar edhe ligje të veçanta, ndër to hyn edhe Ligji për Liritë Fetare në RKS.

Fjalë kyçe: liria e besimit fetar, deklarata universale për të drejtat e njeriut, barazia, konventa evropiane për të drejtat e njeriut, ligji për lirinë fetare në Kosovë, diskriminimi, limiti i kufizimit.